



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV-PROTOKOLLIT

Nr. 1687/3 Prot.,

Tiranë, më 08.04.2024

**SHPALLJE**  
**TË LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR**  
**DREJTORIA RAJONALE E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT**  
**QARKU KORÇË**

Në mbështetje të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr.297 datë 23.6.2022. të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Manualit të Rekrutimit (i ndryshuar),

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**, në përfundim të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara nga kandidatët për 1 (një) pozicion të lirë pune të shpallur në Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Korçë në pozicionin:

- **1 (një)** pozicion të lirë pune **“Inspektor”** në Sektorin e Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU në Drejtorinë Rajonale të AKU-së Qarku Korçë;

### **N J O F T O N:**

1. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është si vijon:

- 1. Znj. Marisa Rënza**
- 2. Znj. Bruna Shëllira**

2. Intervista do të zhvillohet më datë **09.04.2024, ora 11:00**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, adresa Bulevardi "Zogu i I-rë", Godina Nr.13, Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë.

3. Kandidati do të intervistohet në lidhje me:

- Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës për të drejtat e detyrimet e punëdhënësit e punëmarrësit;
- Njohuri mbi Ligjin Nr.9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar;
- Njohuri mbi VKM-në nr. 708 datë 09.09.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit";
- Njohuri mbi Ligjin nr. 10433 datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".

4. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës
- 50 pikë për intervistën me gojë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**EDMOND RRUSHI**

